



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 24.2.2025

Nr: 151

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “MUNDËSIA”, ME  
KRYETAR Z. AGRON SHEHAJ, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR  
PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot, më datë 24.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1131 prot., datë 19.2.2025, me:

**KËRKUES:** Partia politike “MUNDËSIA”, me kryetar z. Agron Shehaj

**OBJEKTI:** Regjistrimi i partisë politike “MUNDËSIA”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025

**BAZA LIGJORE:** Neni 64, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Partia “MUNDËSIA” nëpërmjet Kryetarit, z. Agron Shehaj, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Data: 24.2.2025 Nr: 151  
Ora: 14:00



Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “MUNDËSIA”, me Kryetar z. Agron Shehaj, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, datë 22.1.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “MUNDËSIA”, me Kryetar z. Agron Shehaj, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “MUNDËSIA”, me adresë: Rruga "Myslym Shyri", Shëtitorja "Murat Toptani", Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Agron Shehaj, me adresë: Rruga “Myslym Shyri”, Shëtitorja "Murat Toptani, pranë pallatit mbretëror, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Z. Gjergji Fejzollari, me adresë: Rruga "Myslym Shyri", Shëtitorja "Murat Toptani”, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Orjon Nallbati, me adresë: Rruga "Myslym Shyri", Shëtitorja "Murat Toptani", Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “MUNDËSIA”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia“ MUNDËSIA”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”.

## V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike “MUNDËSIA”, me kryetar Z. Agron Shehaj, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**